

L I G J

PROJEKT

Nr. _____, datë. _____

“PER AUTORITETIN E MBIKQYRJES FINANCIARE”

Në mbështetje të neneve ____, ____ të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1

Objekti i ligjit

Objekti i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për themelimin, qëllimin, funksionet dhe funksionimin e Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare, që në vijim do të quhet thjesht “Autoriteti”.

Neni 2

Fusha e veprimtarisë së Autoritetit

Fusha e veprimtarisë së Autoritetit është rregullimi dhe mbikqyrja mbi :

1. Tregun e Titujve dhe veprimtarinë e tregut të titujve, në të cilën përfshihen veprimtaritë e subjekteve të tjera të përfshira në këtë treg;
2. Tregun e Sigurimeve dhe veprimtarinë e tregut të sigurimeve, në të cilën përfshihen të gjitha veprimtaritë e sigurimit, risigurimit, ndërmjetësimit dhe operacionet që rrjedhin nga këto veprimtari;
3. Institutet Private të Pensioneve dhe veprimtarinë e tregut të pensioneve suplementare, në të cilën përfshihen të gjitha veprimtaritë e sigurimit të pensioneve suplementare të ofruar nga institutet private të pensioneve suplementare

4. si dhe veprimtari të tjera të lidhura me qiranë financiare, faktoringun dhe mortgage sipas percaktimeve të dhëna nga ligjet e fushës;

që në vijim do të quhen “tregje financiare jo-bankare”.

KREU II

STATUSI, STRUKTURA DHE ADMINISTRIMI I AUTORITETIT

Neni 3

Statusi i Autoritetit

Autoriteti është institucion i pavarur i administratës shtetërore, i specializuar për të rregulluar dhe mbikqyrur aktivitetin e subjekteve të mbikqyrur.

Autoriteti është person juridik, me seli në Tiranë.

Autoriteti, në ushtrimin e detyrave të tij, është i pavaruar nga pushteti ekzekutiv, dhe për aktivitetin që ai ushtron, në përputhje me këtë ligj, raporton në Kuvend.

Neni 4

Bordi i Autoritetit

Organi vendimmarrës i Autoritetit, është Bordi i cili përbëhet nga 7 Anëtarë: një Kryetar, dy Nënkryetarë dhe katër Anëtarë të tjerë.

Neni 5

Kërkesat për t’u emëruar anëtar i BORDIT

Anëtarët e Bordit, janë:

1. shtetas shqiptarë;
2. me arësim të lartë juridik, ekonomik ose të lidhur me shkencën e aktuarëve;
3. kanë kualifikimet e duhura profesionale si dhe
4. kanë eksperiencë në njërën nga këto fusha:
 - a. financë-kontabilitet;
 - b. administrim i shoqërive tregtare
 - c. këshillim ligjor i shoqërive tregtare;
 - d. hartim legjislativ;
 - e. bankë;
 - f. shkencës së aktuarëve.
5. kanë integritet moral dhe profesional;

6. të paangazhuar në funksione drejtuese politike partiake.

Anëtarët e Bordit, përzgjidhen midis individëve që plotësojnë këto kërkesa:

1. Nuk janë shpallur si të dënuar penalisht me vendim gjyqësor të formës së prerë;
2. Plotësojnë kërkesat e dispozitave ligjore për konfliktin e interesave.

Kryetari dhe Nënkryetarët e Bordit, nuk ushtrojnë aktivitete të tjera me pagesë, me përjashtim të mësimdhënies, aktiviteteve kërkimore-shkencore, apo pjesëmarrjes si anëtarë në organizatat vendase ose ndërkombëtare e që kanë lidhje me aktivitetin që ushtron Autoriteti.

Katër anëtarët e tjerë të Bordit, nuk mund të jenë anëtarë të më shumë se një Bordi apo organi vendimmarrës të ndonjë Autoriteti tjetër mbikqyrës.

Çdo anëtar i Bordit deklaron përpara kryetarit të Kuvendit, në lidhje me rrethanat e parashikura në këtë nen.

Neni 6

Emërimi i Anëtarëve të Bordit.

Anëtarët e Bordit emërohen nga Kuvendi.

Kryetari, dy Nënkryetarët si dhe dy prej anëtarëve të Bordit emërohen nga Kuvendi me propozim të Këshillit të Ministrave.

Një anëtar i Bordit emërohet nga Kuvendi sipas propozimit të Komisionit të Ligjeve.

Një anëtar i Bordit emërohet nga Kuvendi sipas propozimit të Komisionit të Ekonomisë.

Ministri i Financave, Këshilli Mbikqyrës i Bankës së Shqipërisë si dhe Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, kanë të drejtë t'i propozojnë Këshillit të Ministrave nga një kandidat për anëtar të Bordit të Autoritetit Mbikqyrës. Këshilli i Ministrave mbi bazën e dy kandidaturave të veta si dhe kandidatëve të propozuara nga Ministri i Financave, Këshilli Mbikqyrës i Bankës së Shqipërisë si dhe Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, harton propozimet për Kuvendin.

Në propozim, përcaktohet edhe funksioni që kandidatët do të mbajnë në Bordin e Autoritetit. Në rastin e Nënkryetarëve, në propozim përcaktohet se cili është Departamenti që do të drejtojë secili prej tyre.

Kuvendi, në vendimin e emërimit të secilit prej Nënkryetarëve, përcakton edhe Departamentin që do të drejtohet prej tij.

Neni 7

Mandati i Anëtarëve të Bordit

Mandati i Kryetarit të Bordit është 6 vjet. Mandati i Nënkryetarëve dhe i Anëtarëve të tjerë të Bordit është 5 vjet. Në rastet kur mandati i Kryetarit, Nënkryetarit apo anëtarit të Bordit ka përfunduar, secili prej tyre qëndron në detyrë deri në mometin e zgjedhjes së anëtarëve të rinj.

Individët që janë emëruar një herë si anëtarë të Bordit të Autoritetit, kanë të drejtë të riemërohen vetëm një herë. Individit që është emëruar një herë Kryetar i Bordit të Autoritetit Mbikqyrës, nuk mund të riemërohet si Kryetar.

Në përfundim të mandatit, anëtari i Bordit nuk mund të punësohet për një periudhë një vjeçare, nga ndonjëri prej subjekteve të mbikqyrur nga Autoriteti.

Individët që kanë qenë emëruar në detyrën e Kryetarit dhe Nënkryetarit të Bordit, pas largimit nga detyra përfitojnë për një vit nga e drejta për shpërblim në vlerën e pagës që kanë mbajtur kur kanë qenë në detyrë. Nga kjo e drejtë nuk përfiton individit që është riemëruar anëtar i Bordit.

Neni 8

Lirimi nga detyra i Anëtarëve të Bordit

Kuvendi vendos lirimin nga detyra të ndonjërit prej Anëtarëve të Bordit, përpara afatit të parashikuar në paragrafin e parë të nenit 7 të këtij Ligji, në rastet kur:

- a. jep dorëheqjen;
- b. bëhet i paaftë për të përmbushur detyrën për të cilën është emëruar, për më shumë se 3 muaj;
- c. për shkak të rrethanave të reja, nuk respektohen më, kushtet e parashikuara në pikat 5 dhe 6 të paragrafit të parë të nenit 5 si dhe kushtet e parashikuara në paragrafet 2, 3, dhe 4 të nenit 5 të këtij ligji;
- d. në rast të mungesës, pa arsye të justifikueshme, në më shumë se tre mbledhje rradhazi;
- e. gjatë ushtrimit të funksioneve të veta, vepron në kundërshtim me detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit;
- f. për shkak të paaftësisë apo neglizhencës i shkakton dëm Autoritetit, apo imazhit të Autoritetit si institucion i pavarur.

Propozimi për lirimin nga detyra të ndonjërit prej anëtarëve të Bordit, i paraqitet Kuvendit nga secili prej institucioneve që kanë të drejtën e propozimit për anëtarët e Bordit, ose nga institucione të tjera, funksioni i të cilave është i lidhur me atë të Autoritetit. Në propozim, përcaktohet arsyeja si dhe provat në lidhje me rastin. Kuvendi, mund të vendosë pezullimin e anëtarit nga funksioni deri në përfundimin e procesit të verifikimit dhe marrjes së vendimit. Kuvendi, pas shqyrtimit vendos në lidhje me propozimin për lirimin nga detyra, duke miratuar lirimin ose duke refuzuar propozimin e bere.

Bordi informon Kuvendin në lidhje me konstatimin e rrethanave të parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni.

Në rast të liritimit nga detyra përpara afatit, të ndonjërit prej anëtarëve të Bordit, anëtari tjetër emërohet me të njëjtën procedurë siç është emëruar anëtari që lirohet, për periudhën deri në përfundim të afatit të madatit të anëtarit që lirohet.

Neni 9

Kompetenca në miratimin e strukturës

dhe pagave të Autoritetit

Paga mujore e Kryetarit të Bordit, e Nënkryetarëve si dhe Shpërblimi për Anëtarët e tjerë që nuk kyejnë funksione ekzekutive në Autoritet, miratohen nga Kuvendi, me propozim të Bordit të Autoritetit.

Struktura e Autoritetit miratohet nga Kuvendi me propozim të Bordit të Autoritetit.

Autoriteti, përveç njësive të tjera, është i përbërë nga dy Departamente kryesore. Emërtimi i këtyre departamenteve si dhe i njësive të tjera të Autoritetit, përcaktohet nga struktura e Autoritetit.

Bordi miraton rregulloren e tij, në lidhje me strukturën, funksionet e veçanta dhe përgjegjësitë e departamenteve dhe drejtorive, procedurat e komunikimit midis tyre si dhe të drejtat e nëpunësve dhe punonjësve të tjerë në detyrë.

Neni 10

Mbledhjet e Bordit

Mbledhjet e Bordit, thirren me iniciativë të Kryetarit të Bordit ose me kërkesë të secilit prej anëtarëve të tij. Bordi mbledhet të paktën një herë në muaj për të diskutuar dhe vendosur në lidhje me rendin e ditës.

Mbledhjet e Bordit drejtohen nga Kryetari, dhe në mungesë sipas autorizimit të lëshuar prej tij, nga njëri prej Nënkryetarëve.

Mbledhja e Bordit konsiderohet e vlefshme në rastet kur janë prezent të paktën katër anëtarë.

Vendimet e Bordit konsiderohen të vlefshme kur merren me shumicën e votave të anëtarëve në detyrë.

Në votim nuk lejohet abstenimi.

Për çdo mbledhje mbahet Proces-Verbal. Proces-verbali nënshkruhet nga të gjithë anëtarët që kanë qenë prezent në mbledhje. Vendimet e Bordit nënshkruhen nga Kryetari si dhe Nënkryetari përgjegjës në lidhje me çështjen për të cilën është marrë vendimi. Në rast se vendimi është i natyres së përgjithshme, ai nënshkruhet nga Kryetari si dhe nga dy Nënkryetarët.

Bordi miraton rregulloren në lidhje me funksionim dhe mbajtjen e proces-verbalit të mbledhjes.

Neni 11

Transparenca në veprimtarinë e Autoritetit

Bordi, njofton publikisht politikat dhe praktikat që ai ndjek për zbatimin e dispozitave ligjore dhe nënligjore si dhe motivet e ndryshimit të tyre.

Politikat që ai ndjek për zbatimin e dispozitave sipas paragrafit të parë të këtij neni, përfshijnë edhe mjetet e zgjedhura nga Autoriteti dhe të përdorura në mënyrë të pavarur prej tij, gjatë përmbushjes së objektivave të këtij ligji.

Autoriteti miraton rregullore për procedurat e vënies në dispozicion të publikut të dokumentacionit të tij, si dhe afatet dhe kushtet për mbajtjen e kopjeve të çertifikuara të këtij dokumentacioni.

Bordi miraton rregullore në lidhje me llojet e publikimeve, afatet e botimit të tyre si dhe në lidhje me hartimin dhe funksionimin e faqes në internet të Autoritetit.

KREU III

OBJEKTIVAT, KOMPETENCAT E AUTORITETIT

DHE TE DREJTAT E BORDIT

Neni 12

Objektivat e Autoritetit

Në përmbushje të funksioneve dhe kompetencave të parashikuara në këtë ligj, Autoriteti udhëhiqet nga objektivat si vijon:

1. Të mbrojë interesat e investitorëve dhe personave të siguruar;
2. Të nxisë qëndrueshmërinë, transparencën dhe besueshmërinë e tregjeve financiare jobankare;
3. Të sigurojë respektimin e ligjit.

Neni 13

Qëllimi i punës së Autoritetit

Autoriteti, me gjithë strukturat e tij ka për detyrë:

1. të rregullojë veprimtarinë e subjekteve të mbikqyrur, nëpërmjet hartimit të akteve nënligjore të parashikuara nga Ligji si dhe publikimit të udhëzimeve e materialeve shpjeguese;
2. të sigurojë mbikqyrjen shtetërore mbi tregun e titujve, tregun e sigurimeve si dhe skemat e pensioneve suplementare, të cilat rregullohen e funksionojnë në përputhje me ligjet e fushës.

Në ushtrim të kompetencave të parashikuara nga neni 2 i këtij Ligji, Autoriteti, zyrat e tij si dhe personat e autorizuar prej tij, kanë të drejta të plota në lidhje me:

1. miratimin, lëshimin apo refuzimin e liçencave për subjektet që kërkojnë të ushtrojnë veprimtari në njërin prej tregjeve financiare jo-bankare;
2. vëzhgimin dhe organizimin e mbikqyrjes së subjekteve që kërkojnë të ushtrojnë veprimtari në njërin prej tregjeve financiare jo-bankare;
3. ndjekjen e zbatimit të këtij ligji dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij si dhe zbatimin e masave shtrënguese.

Subjektet, qofshin këta individë apo persona fizikë apo juridikë, që ushtrojnë veprimtari të përmendura në nenin 2 të këtij Ligji, në vijim, do të quhen "subjekte të mbikqyrura".

Neni 14

Kompetencat e Bordit

Bordi ka këto kompetenca:

1. në përputhje me strukturën, harton rregullat në lidhje me përshkrimin e punës si dhe me qëllimin e punës;
 2. harton dhe miraton parimet bazë të veprimtarisë së tij;
 3. harton dhe miraton rregulla dhe udhëzime të parashikuara nga ligji;
 4. shpërndan udhëzues të shkruar në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e Ligjeve që rregullojnë fushën e veprimtarisë si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tyre;
 5. miraton formatin e liçencave që lëshohen për ushtrimin e veprimtarive të mbikqyrura nga Autoriteti;
 6. lëshon ose refuzon liçenca ose leje për të ushtruar veprimtari në njërin prej tregjeve financiare jobankare të mbikqyrura nga Autoriteti. Në zbatim të kësaj kompetence Bordi:
- në përputhje me afatet, kushtet dhe procedurat e parashikuara në legjisllacionin shqiptar për titujt, miraton ose refuzon prospektusin për ofertën publike ose për regjistrimin e emetimeve të reja për shitje sipas rregullave të tregut të rregulluar të titujve;

- siguron zbatimin e vendimeve të përkohëshme apo përfundimtare, për publikimin e ofertave publike të aksioneve;
 - miraton liçencat e individëve apo shoqërive që kërkojnë të ushtrojnë veprimtari në tregun e titujve përfshirë këtu veprimtarinë si treg titujsh, tregtarë të titujve, regjistruar, ndërmjetesa apo këshilltari investimesh si dhe subjekteve të tjera të përfshira në treg;
 - miraton liçencat e shoqërive që kërkojnë të ushtrojnë veprimtari si administrues të fondeve të investimit si dhe liçencat për ushtrimin e veprimtarisë si shoqëri investimi;
 - miraton statutin si dhe ndryshimet e statutit të shoqërive që kërkojnë të ushtrojnë veprimtari në tregun e titujve;
 - në përputhje me ligjin që rregullon veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime, miraton liçencat për ushtrimin e veprimtarisë së sigurimit si dhe ato për ushtrimin e veprimtarisë së ndërmjetësimit në sigurime dhe operacionet që rrjedhin drejtpërdrejt nga këto veprimtari;
 - shqyrton kërkesat për zgjerim veprimtarie të bëra nga subjekte që ushtrojnë veprimtari në tregun e sigurimeve;
 - shqyrton kërkesat për ushtrim veprimtarie jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë si dhe ato për hapje zyre përfaqësimi të shoqërive të huaja;
 - shqyrton kërkesat për transferim portofoli si dhe për dhënien në sipërmarrje të disa nga funksioneve të shoqërisë së sigurimit;
 - miraton bashkimin ose ndarjen e shoqërive të sigurimit;
 - miraton statutin e shoqërive të sigurimit si dhe ndryshimet e statutit përpara se ato të paraqiten për miratim përpara asamblesë së përgjithshme të aksionerëve;
 - shqyrton kërkesat për pjesëmarrje influencuese në shoqëritë e sigurimit si dhe investimet e kapitalit të shoqërive të sigurimit;
 - miraton likuidimin vullnetar dhe vendos për fillimin e procedurave të falimentimit për shoqëritë e sigurimit;
 - miraton statutin si dhe ndryshimet e statutit të shoqërive që kërkojnë të ushtrojnë veprimtari si Institut privat Pensionesh përpara regjistrimit në Gjykatë;
 - ndërmerr masa korigjuese të përshtatshme dhe në kohën e duhur në rastet kur shoqëria e sigurimit ose risigurimit nuk arrin nivelin e kërkuar të aftësisë pagueuse ose konstatohen raste të mosplotësisë të aftësisë pagueuse, siç është përcaktuar në legjislacionin në fuqi për fushën e sigurimeve dhe risigurimeve;
 - miraton udhëzues metodologjik, formën e kontratës së sigurimit, lista, tipe shkresash dhe dokumenta të tjera të lidhura me veprimtarinë e instituteve private të pensioneve;
 - miraton rregulloret e instituteve private të pensioneve suplementare si dhe ndryshimet në këto rregullore, dhe kontrollon zbatimin e tyre;
 - miraton llojin, format dhe përmbajtjen e raporteve që i paraqiten Bordit nga subjektet e liçencuar;
 - miraton transferimin e paketës kontrolluese të subjekteve të mbikqyrur.
1. kufizion ose ndalon investimet te shoqerise se sigurimit dhe te shoqerise se risigurimit, kur vertetohet se keto investime nuk jane ne perputhje me raportet rregullatore te vendosura dhe kur rrezikojne pozicionin financiar te shoqerise;

2. brenda nje muaji nga paraqitja e kekrkesës, shqyrton kushtet e pergjithshme dhe te vecanta te kontrates se sigurimit, qe shoqeria e sigurimit kerkon te hedhe ne treg;
 3. miraton pasqyrat financiare te shoqerive te sigurimit dhe te shoqerive te risigurimit;
 4. miraton dhe shperndan standarte kontabel, si dhe formatet e raportimit financiar, te detyrueshme per t'u zbatuar nga te licensuarit;
 5. miraton listën e ekspertëve kontabël që mund të ushtrojnë këtë funksion për shoqëritë që operojnë në tregjet financiare jobankare;
 6. në rastet e parashikura nga ligji merr vendim per fillimin e procedurave të falimentimit për subjektet e mbikqyrur dhe kur kjo parashikohet nga ligji, emëron likuidatorin;
1. miraton politikën e pagave dhe të shperblimeve të nëpunësve dhe të punësuarve të tjerë të Autoritetit;
 2. në funksion të veprimtarisë së Autoritetit, merr vendime për lidhjen e memorandumeve të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit me autoritete brenda dhe jashtë vendit,;
 3. diskuton periodikisht raportet që lidhen me aktivitetin e departamenteve kryesore të Autoritetit;
 4. miraton projektbuxhetin dhe Raportin Vjetor të Autoritetit Mbikqyrës;
 5. brenda muajit Qershor të çdo viti, miraton Raportin mbi Industrinë në lidhje me gjendjen dhe perspektivën e tregut të mbikqyrur nga Autoriteti;
 6. në rregulloren për procedurat e brendshme administrative, miraton afatet për paraqitjen e çështjeve për shqyrtim;
 7. miraton manualet e inspektimit;
 8. vendos në lidhje me blerjen e shërbimit të këshillimit nga ekspertë të fushës;
 9. kompetenca të tjera të parshikuara nga ky ligj apo nga ligjet e fushës.

Vendimet e marra, arësytohen dhe janë objekt ankimi përpara Gjykatës.

Vendimet administrative të Bordit publikohen në format e vendosura nga Bordi për publikimin e njoftimeve zyrtare.

Neni 15

Kompetencat e Kryetarit të Bordit

Kryetari i Bordit funksionon edhe si drejtor i përgjithshëm ekzekutiv. Ai organizon dhe administron veprimtarinë e Autoritetit dhe administratës së tij, përveç aktiviteteve që janë kompetencë e Nënkryetarëve të Bordit apo Anëtarëve të tjerë të tij, të parashikuara nga ky ligj apo ndonjë akt tjetër.

Kryetari i Bordit ka për detyrë:

1. të përfaqësojë Autoritetin;
2. të thërrasë dhe drejtojë mbledhjet e Bordit;

3. të bashkërendojë punën e Nënkyetarëve;
4. të nënshkruajë si dhe të zgjidhë kontratat e punës me personat e punësuar në administratën e Autoritetit si dhe të propozojë raportin e pagave të nëpunësve dhe punonjësve të tjerë të administratës;
5. të organizojë, drejtojë dhe kontrollojë veprimtarinë e administratës;
6. të organizojë punën për përgatitjen dhe paraqitjen për miratim përpara Bordit, të projektbuxhetit;
7. të organizojë punën për zbatimin e buxhetit, mbylljen e vitit financiar si dhe raportin financiar, dhe i paraqet ato për miratim përpara Bordit.
8. nënshkruan kallzimet penale në rastet e zbulimit të informacionit për veprime apo mosveprime që përbëjnë vepër penale.
9. shkëmben informacione me Bankën e Shqipërisë, me institucione dhe agjenci të tjera qeveritare, me autoritete dhe administrata vendore, me Organizata jo Fitimprurëse që ushtrojnë veprimtari në tregjet financiare jobankare të mbikqyrura nga Autoriteti si dhe me subjektet e mbikqyrur;
10. në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë, me urdhër të përbashkët urdhëron, kryerjen e inspektimeve në bankat depozitare në lidhje me aktivitetet e subjekteve të liçencuara nga Autoriteti e që ushtrojnë veprimtari në njërin prej tregjeve financiare jobankare të mbikqyrura nga Autoriteti.
11. të kërkojë nga Banka e Shqipërisë, që kjo të ushtrojë inspektime me objekt të caktuar, në bankat e këtij niveli në përputhje me Ligjin “Për Bankat e nivelit të dytë”, si dhe të vihet në dijeni për rezultatet e dala nga kontrolli.
12. të krijojë Komitete Këshillimore, që e mbështesin në ushtrimin e funksioneve tëtij.

Neni 16

Kompetencat e Nënkyetarëve

Kompetencat e Nënkyetarëve përcaktohet në rregullat në lidhje me përshkrimin e punës të miratuar nga Bordi.

Nënkyetarët e Bordit, sipas përcaktimit të dhënë në vendimin e emërimit, janë secili drejtues i njërit prej dy departamenteve kryesorë të Autoritetit Mbikqyrës. Brenda kompetencave ligjore, Nënkyetari organizon, drejton dhe përgjigjet për punën e Departamentit përkatës.

Neni 17

Kompetenca të Anëtarëve

që nuk kanë funksione ekzekutive

Katër Anëtarët e Bordit, të cilët nuk kryejnë funksione drejtuese në Autoritetin, në rastet kur kërkohet shqyrtimi i një çështjeje të veçantë, funksionojnë si Komiteti i Auditit. Anëtarët e Bordit shqyrtojnë dokumentacionin dhe përgatisin raporte të detajuara të cilat ja paraqesin Bordit. Nëse konstatohen shkelje apo mangësi, raporti përmban rekomandime për masat që duhet marrë në lidhje me mangësitë dhe shkeljet e konstatuara gjatë veprimtarisë së Bordit apo strukturave të tij.

Komiteti i Auditit, nga anëtarët e tij, emëron një raportues, i cili shqyrton apelimet dhe ankesat kundër vendimeve të Bordit dhe organeve të tij.

Raportuesi gëzon të gjitha të drejtat për kryerjen e inspektimit të plotë në lidhje me çështjen. Lidhur me vendimet e apeluara, raportuesi përgatit raporte të detajuara dhe ja paraqet ato Bordit. Nëse konstatohen shkelje apo mangësi, raporti përmban rekomandime për masat që duhet marrë në lidhje me mangësitë dhe shkeljet e konstatuara gjatë veprimtarisë së Bordit apo strukturave të tij.

Bordi, shqyrton raportin e paraqitur dhe vendos në lidhje me masat e propozuara, nëse ka të tilla.

Kuvendi vendos në lidhje me auditimin e jashtëm të Autoritetit.

Autoriteti i nënshtrohet dispozitave ligjore për prokurimet publike.

Neni 18

Procedurat e Ekzekutimit të të Drejtave të

Bordit dhe Strukturave të Autoritetit

Në ushtrimin e të drejtave të Bordit si dhe të gjithë strukturave të tjera të Autoritetit, anëtarët e Bordit si dhe nënpunësit e emëruar, gëzojnë këto të drejta në përputhje me procedurat e parashikuara në këtë ligj si dhe me detyrën që ju është ngarkuar të kryejnë:

1. të kërkojnë nga subjektet e mbikqyrura si dhe subjekte të tjera, që kanë vepruar në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, apo të ligjeve që rregullojnë tregjet e fushës, shpjegime me shkrim, dokumentacion, përfshirë kopje të certifikuara dokumentash, të dhëna, informacione, dhe të dhëna të tjera, si dhe të verifikojnë dokumentacionin dhe raportimet e bëra. Dokumentacioni dhe informacionet e shkruara duhet të jenë në gjuhën shqipe;

2. të marrin të dhëna në lidhje me fondet, asetet përfshirë titujt si dhe asete të tjera, në pronësi të subjekteve të mbikqyrur;

3. të inspektojë llogaritë, dokumentet tregtare si dhe dokumentacione të tjera, që kanë lidhje me transaksionet e kryera;

4. të drejtojë kundërinspektimin. Me "kundërinspektim" do të kuptohet inspektimi tek palë të treta, me qëllim verifikimin e inspektimit të bërë më parë në subjekte të mbikqyrura;

5. u kërkon palëve të treta, informacion, dokumentacion përfshirë kopje të certifikuara të dokumentave, deklarata mbi llogaritë, dhe të dhëna të tjera të nevojshme për realizimin e kundër inspektimeve;

7. të ndjekin mbledhjet e organizuara nga strukturat drejtuese dhe kontrolluese të personave të mbikqyrur.

Me qëllim zbatimin e ushtrimit të procedurave të mbikqyrjes, Nënkryetari përgjegjës, për një subjekt të mbikqyrur mund të kërkojë nga Bordi, emërimin e ekspertëve të jashtëm, në përputhje me kërkesat specifike të miratuara nga Bordi. Shpenzimet në këtë rast do të përballohen nga subjekti i mbikqyrur.

Me kërkesë të Kryetarit të Bordit, bankat janë të detyruara që për subjektet e mbikqyrur nga Autoriteti, të japin informacion në lidhje me numrat dhe kodet e llogarive ekzistuese apo atyre ose të mbyllura, së bashku me datën e transaksionit të fundit të kryera në to.

Të gjitha të dhënat dhe dokumentat që kanë të bëjnë me shkelje të këtij ligji, të cilat kanë në përmbajtjen e tyre emrin e personit i cili është marrë me hartimin e tyre, ju dorëzohen palëve të treta nga Kryetari i Bordit, vetëm me miratimin paraprak të personit të mësipërm, me përjashtim të rasteve kur ligji e parashikon ndryshe.

Policia, Zyrat e Prokurorisë dhe të gjitha autoritetet e tjera shtetërore detyrohen që brenda kompetencave të tyre, të ndihmojnë, Autoritetin dhe punonjësit e tij, gjatë përmbushjes së detyrave të tyre në ushtrim të funksioneve mbikqyrëse.

Në kuadër të ushtrimit të kompetencave të ngarkuara nga ky ligj, Autoriteti mund të ndërmarrë inspektime të përgjithshme në bashkëpunim me autoritetet e tatim-taksave.

Anëtarët e Bordit të Autoritetit si dhe nëpunësit e tjerë të administratës së tij, nuk janë financiarisht përgjegjës për dëme që shkaktojnë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre inspektuese, me përjashtim të rasteve kur ata kanë kryer një krim apo kanë kryer veprime të qëllimshme.

Neni 19

Inspektimi

Inspektimi ushtrohet nga nëpunësit e Autoritetit, sipas përcaktimit të bërë në urdhërin e nënshkruar nga Kryetari ose një nga Nënkryetarët. Inspektimi bëhet me ose pa lajmërim.

Nëpunësit e emëruar në përputhje me paragrafin 1, inspektojnë në lidhje me:

1. respektimin e dispozitave ligjore dhe nënligjore të legjislacionit që rregullon veprimtarinë e tregjeve financiare jo-bankare;

2. parandalimin dhe identifikimin e shkeljeve.

Subjekti i mbikqyrur, për ushtrimin e inspektimit, është i detyruar të sigurojë kushte normale pune, si dhe të ofrojë dokumentacion ose informacion tjetër të shkruar në gjuhën shqipe.

Nëpunësit e administratës së Autoritetit, janë të detyruar të prezantohen para fillimit të procedurave të inspektimit duke paraqitur urdhërin e përmendur në paragrafin e parë të këtij neni.

Subjekti i mbikqyrur është i detyruar të ndihmojë Autoritetin dhe administratën e tij dhe për këtë qëllim:

1. ju siguron atyre mjetet e nevojshme për inspektim nëse ju kërkohet, i përgjigjen pyetjeve në mesin e Autoritetit;
2. nga rradhët e të punësuarve, cakton personat e kontaktit për të ndihmuar në kryerjen e inspektimit;
3. siguron hyrje të plote në ambjentet e zyrave;
4. vë në dispozicion të gjitha llogaritë, dokumentacionin tregtar dhe çdo dokumentacion tjetër, të nevojshem për të përcaktuar faktet dhe rrethanat e lidhura me çështjen për të cilën kryhet inspektimi;
5. pas një kërkesë paraprake, siguron dhe ve në dispozicion fotokopje të llogarive dhe dokumentave të tjere, duke vënë në këto dokumenta me shkronja shtypi shenimin: "e njëjte me origjinalin" si dhe datën dhe firmën e personit të autorizuar nga personi i inspektuar.

Raporti përfundimtar për çdo inspektim, pregatitet në dy kopje dhe firmoset nga nëpunesi i Autoritetit që kryen inspektimin, si dhe i paraqitet për kundërfirme personit që përfaqëson subjektin e mbikqyrur.

KREU IV

ADMINISTRATA E AUTORITETIT MBIKQYRËS

Neni 20

Organizimi dhe detyrimet

Aktiviteti i Autoritetit mbështetet nga një administratë e cila funksionon në përputhje me rregulloren e brendshme të përshkrimit të punës së administratës së Autoritetit, si dhe rregulloret e tjera në lidhje me funksionimin e administratës, që miratohen nga Bordi sipas propozimit të Kryetarit.

Marrdhëniet e punës me punonjësit e kësaj administrate rregullohen sipas Kodit të Punës.

Nuk mund të punësohen në strukturat e Autoritetit individë të cilët:

1. janë dënuar penalisht me vendim gjyqësor të formës së prerë;
2. janë ortakë apo aksionerë në subjekte të mbikqyrur;
3. kanë qenë anëtarë të organeve ekzekutive ose kontrolluese të subjekteve të mbikqyrur;
4. janë të martuar apo kanë lidhje familjare direkte ose indirekte gjaku deri në shkallë të tretë me personat e parashikuar në paragrafin 3, me anëtarët e Bordit, apo me punonjës të tjerë të administratës me të cilët kanë lidhje hierarkike varësie administrative;
5. janë punonjës me kohë të pjeshme apo të plotë në subjektet e mbikqyrur;
6. nuk gëzojnë reputacion të mirë dhe kanë patur raste të cënimit të etikës.

Neni 21

Shpërblimi i administratës

Rregullat e brendshme për raportet e pagave, pagat mujore të punonjësve të Autoritetit si dhe shpërblimet përcaktohen nga Bordi sipas propozimit të Kryetarit.

KREU V

DEKLARIMI I KONFLIKTIT TE INTERESIT

Neni 22

Konflikti i interesit

Anëtarët e Bordit si dhe nëpunësit e Autoritetit janë të gjithë të detyruar të bëjnë deklarin e pasurisë, në momentin e marrjes së detyrës si dhe më tej, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Anëtarët e Bordit, nuk marrin pjesë në procedurë të diskutimit, votimit dhe vendimarrjes, nëse kanë interes direkt ose indirekt për çështjen, interes i cili cënon paanësinë e tyre në qëndrimet zyrtare.

Nëpunësi i Autoritetit, nuk merr pjesë në inspektime ndaj subjekteve të mbikqyrur nëse ka interesa direkte ose indirekte për çështjen për të cilën kryhet inspektimi, interes i cili cënon paanësinë e tyre në qëndrimet zyrtare.

Anëtarët e Bordit si dhe nëpunësit e Autoritetit, nëse konstatojnë se ndodhen përpara rastit të parashikuar përkatësisht në paragrafin e dytë ose të tretë të këtij neni, e deklarojnë me shkrim këtë fakt dhe tërhiqen nga shqyrtimi i çështjes.

Në rast se konstatohet se megjithëse kanë qënë ndodhur përpara rastit të përmendur përkatësisht në paragrafin e dytë apo të tretë të këtij neni, dhe nuk kanë bërë deklaramin përkatës e për pasojë nuk janë tërhequr nga shqyrtimi i çështjes, ndaj tyre merret masa e lirimimit ose e largimit nga detyra. Masa e lirimimit ose e largimit nga detyra, nuk ndikon në vendimet e marra deri në atë moment.

KREU VI

KODI ETIK, PROFESIONALIZMI DHE KONFIDENCIALITETI

Neni 23

Kodi etik dhe Profesionalizmi

Anëtarët e Bordit dhe punonjësit e tjerë të Autoritetit gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, zbatojnë Kodin e Etikës dhe standartet profesionale, të miratuara nga Bordi, sipas propozimit të Kryetarit.

Për rastet kur konstatohet shkelja e Kodit të Etikës, merren masa disiplinore deri në lirimim ose largimin nga detyra.

Neni 24

Konfidencialiteti

Informacioni që i bëhet i njohur Autoritetit, i siguruar në ushtrim të aktivitetit mbikqyrës të këtij institucioni, përhapja e të cilit mund të çënojë interesat tregtare ose emrin e mirë të subjektit të mbikqyrtur, klasifikohet informacion konfidencial.

Nuk konsiderohen informacione konfidenciale, informacionet tregtare të cilat janë siguruar nga subjekti i mbikqyrtur, detyrimi për publikim i të cilave është parashikuar nga ky ligj apo nga ligje të tjera. Klasifikimi i informacionit bëhet me rregullore të brendshme të miratuara nga Bordi.

Anëtarët e Bordit, nëpunësit si dhe punonjësit e tjerë të Autoritetit janë të detyruar të ruajnë dhe të mos shpërndajnë informacionet konfidenciale.

Për rastet kur vërtetohet shkelja e kushteve të parashikuara në këtë nen, merren masa administrative deri në lirimim nga detyra për anëtarët e Bordit ose largimin nga detyra për nëpunësit e tjerë të Autoritetit.

Neni 25

Përfundimi i trajtimit si informacionin konfidencial

Informacionet që janë konsideruar konfidenciale, nuk trajtohen më si të tilla me kalimin e 3 vjetëve nga momenti kur kanë rënë në dorë të Autoritetit. Për kategori të caktuara informacioni, ky afat mund të zgatet me vendim të Bordit.

Bëjnë përjashtim nga respektimi i afatit të parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni, rastet kur:

1. kërkohen nga autoritetet gjyqësore sipas kërkesave ligjore ;
2. kërkohen nga autoritetet mbikqyrëse bankare apo Shërbimet Inteligjente, sipas kriterëve dhe kushteve të parashikuara me marrveshje të përbashkëta;
3. kërkohen nga autoritete mbikqyrëse të vendeve të tjera që kanë aktivitet të njëjtë ose të ngjashëm me atë të Autoritetit, mbi bazën e marrveshjeve të përbashkëta me objekt shkëmbim informacioni dhe kur këto autoritete sigurojnë :
 - a. të paktën të njëjtin nivel konfidencialiteti për informacionin që dërgohet;
 - a. kanë autoritetin dhe bien dakord, që me kërkesë të Autoritetit, të vënë në dispozicion të njëjtin lloj informacioni;
 - b. të kenë arsye të justifikuara për kërkesën për informacion me autorizimin e subjektit të mbikqyrur.

Në dhënien e informacionit, zbatohen dispozitat ligjore në lidhje me të dhënat personale.

Informacioni i marrë nga subjekti i mbikqyrur mund t'i rijepet atij në çdo kohë.

KREU VII

FINANCIMI DHE BUXHETI I AUTORITETIT

Neni 26

Financimi dhe Buxheti

Autoriteti është institucion i pavarur që financohet me burimet e veta. Për çdo diferencë që lind midis burimeve të fondeve dhe përdorimit të tyre, Autoriteti Mbikëqyrës financohet nga buxheti i shtetit deri në momentin kur të ardhurat e autoritetit bëhen të mjaftueshme për të siguruar funksionimin normal të tij. Pjesa e financimit të buxhetit të shtetit për Autoritetin miratohet nga Kuvendi i Shqipërisë si pjesë e pavarur e buxhetit të Shtetit. Buxheti i Autoritetit përgatitet, shpallet dhe hartohet në përputhje me Ligjin organik të buxhetit të shtetit.

Fitimi neto për vitin financiar, kalon në të ardhurat e buxhetit të shtetit brenda katër muajsh pas mbylljes së vitit financiar.

Të ardhurat në buxhetin e Autoritetit krijohen nga:

1. tarifat sipas nenit 27;
2. te ardhurat nga sanksionet ne zbatim te legjislacionit ne fuqi per fushen e tregjeve jo-bankare,
3. shitjet e botimeve periodike te hartuara nga Autoriteti;
4. financime nga buxheti i Shtetit;
5. te tjera burime dhe aktivitete te lejuara nga ligji dhe nga legjislacionit ne fuqi per tregjet jo-bankare.

Tabelat e të ardhurave dhe shpenzimeve hartohen në përputhje me dispozitat ligjore ne fuqi.

Neni 27

Tarifat

Autoriteti në përputhje me listën e tarifave të sipas Aneksit 1 bashkangjitur ketij Ligji, zbaton tarifa për:

1. Dhënien e liçensave për ushtrimin e veprimtarive të parashikuara në Ligjin "Për Letrat me Vlere", ligjin "Për Veprimtarinë e Sigurimit, të Risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", si dhe ligjin "Për Pensionet Suplementare dhe Institutet Private të Pensioneve".
2. miratimin e prospektit të ofertës publike;
3. miratimin e vendimit të Mbedhjes së Përgjithshme të Aksionarëve, për vënien në likujdim të një shoqërie që ushtron veprimtari si institut pensionesh.
4. Miratimin e lejes shtesë për ushtrim të veprimtarive që përfshijnë një tip të ri ose paketë të re sigurimi;
5. shoqerite e sigurimit si shumat e primeve bruto te arketuara ne baze te kontributeve, te cilat duhet te certifikohen cdo vit nga nje auditor i jashtem i shoqerise se sigurimit dhe cdo kontribut qe rezulton i paevidentuar, do t'i paguhet Autoritetit brenda 30 diteve nga nenshkrimi i certifikates se auditimit";
6. Rishikimin e dokumentacionit për publikimin e deklaratave apo njoftimeve në lidhje me çështjet e përmendura në pikat 1, 2, 3,dhe 4 të këtij paragrafi.

Përveç tarifave të paraqitura ne Aneksin 1 bashkangjitur, Bordi në përputhje me dispozitat ligjore, mund të miratojë edhe tarifa të tjera të lidhura me shërbime që mund t'ju ofrohen personave të interesuar.

Tarifa, për efekte tatimore, raportohet si një llogari shpenzimesh të subjektit të mbikqyrrur.

Kryetari i Bordit nxjerr urdhërin për mbledhjen e tarifave që i ka kaluar afati likujdimit dhe që i duhen paguar Autoritetit. Ankimimi i vendimit të Bordit në rrugë gjyqësore nuk e pezullon ekzekutimin e tij.

Pagesat, të cilat konsiderohen të tepërta me vendim gjykatë të formës së prerë, i kthehen subjektit të mbikqyrur.

KREU IIIV

KONTABILIZIMI DHE KONTROLLI

I AKTIVITETIT TE AUTORITETIT

Neni 28

Raportimi dhe kontrolli

Brenda muajit Prill të vitit pasardhës, Autoriteti i paraqet Kuvendit :

1. raportin vjetor mbi veprimtarinë e tij ;
2. deklarinimin mbi gjendjen financiare vjetore dhe
3. raportin mbi realizimin e planit të buxhetit.

Raporti vjetor i Autoritetit mbi veprimtarinë e tij, përveç informacioneve të tjera që mund të kërkojnë nga Kuvendi, përmban informacionin e mëposhtëm:

1. përshtatshmërinë e infrastrukturës ligjore të tregut financiar të mbikqyrur nga Autoriteti;
2. vendimet në lidhje me liçencat, miratimet dhe aktet e tjera individuale administrative të nxjerra në përputhje me këtë ligj, refuzimin e lëshimit të liçencave apo të kërkesave të tjera që i janë paraqitur Autoritetit, rregjistrimet e bëra në regjistra, vendimet e ankimuara të Bordit dhe në mënyrë të detajuar ankimumet që janë dhe të mbështetura nga vendimet e gjykatës;
3. rezultatin e inspektimeve të kryera mbi subjektet e mbikqyrura;
4. politikat e informimit të publikut, si dhe ato të bashkëpunimit të brendshëm dhe ndërkombëtar;
5. organizimin, financimin dhe politikat në lidhje me përzgjedhjen e punonjësve të Autoritetit;
6. të dhëna të tjera sipas vendimit të Bordit.

Autoriteti paraqet përpara Kuvendit çdo informacion dhe dokument të kërkuar nga ky i fundit për aktivitetet e lidhura me të.

KREU IX

REGJISTRAT E AUTORITETIT

Neni 29

Rregjistrat

Autoriteti mban regjistra të hapur për publikun në lidhje me:

1. shoqëritë që ushtrojnë veprimtari si tregje të titujve (bursa);
2. ndërmjetësat e investimeve;
3. shoqëritë publike dhe emetuesit e tjerë të titujve;
4. shoqëritë e investimit;
5. shoqëritë administruese të fondeve të investimit;
6. shoqëritë e investimit;
7. tregtarët e titujve si dhe këshilltarët e investimeve;
8. shoqëritë e sigurimeve;
9. agjentët e sigurimeve;
10. shoqëritë që ushtrojnë veprimtari si institute private të pensioneve

Bordi, sipas propozimit të Kryetarit, miraton regjistra të tjerë si dhe procedurat në lidhje me regjistrimin fillestar, mbajtjen, dhe ruajtjet e regjistrave të dhe gjithashtu procedurat që sigurojnë mirëfunksionimin e regjistrat si një sistem informativ i plotë.

KREU X

GRUPI KONSULATATIV I STABILITETIT FINANCIAR

Neni 30

Funksionimi i GKSF

Grupi Konsultativ i Stabilitetit Financiar, që këtu dhe më poshtë do të njihet me inicialet “GKSF”, krijohet si një trup konsultativ, që:

1. asiston në zhvillimin e politikave të përbashkëta, bashkëpunimin dhe bashkërendimin e veprimeve të anëtarëve të këshillit në rastet kur del e nevojshme të kryhen inspektime mbi subjektet e mbikqyrur;
2. siguron shkëmbimin e informacionit midis anëtarëve të grupit;
3. asiston në ruajtjen, stabilitetin dhe zhvillimin e tregjeve financiare në Republikën e Shqipërisë ;
4. asiston në përmirësimin dhe rritjen e efikasitetit të kontrollit mbi pjesmarrësit e tregjeve financiare.

Anëtarë të GKSF-së janë

- Ministri i Financës;
- Kryetari i Bordit të Autoritetit;
- Guvernatori i Bankës së Shqipërisë.

Me ftesë të GKSF, në mbledhjet e tij, mund të marrë pjesë Kryetari i Komisionit të Ekonomisë të Kuvendit, si dhe persona të tjerë.

GKSF i bën secilit prej përfaqësuesve, rekomandime dhe propozime që kanë për qëllim përmirësimin e praktikave të plotësimit dhe zgjerimit të infrastrukturës ligjore të tregjeve financiare.

Të drejtën për të thirrur mbledhjen e GKSF e ka çdo anëtar.

Mbledhjet e GKSF-së kryesohen nga Ministri i Financave. Mbledhja e parë e GKSF, thirret nga Ministri i Financave brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

KREU XI

SANKSIONET ADMINISTRATIVE

Neni 31

Çdo individ që pengon Autoritetin Mbikqyrës, strukturat e tij ose nëpunësit e autorizuar të administratës së tij, në ushtrimin e kompetencave të tyre mbikqyrëse, të përcaktuar nga ky ligj ose cdo akt tjetër, nëse shkelja nuk përbën krim, dënohen me gjobë nga _____ në _____ lekë. Në rast të përsëritjes së shkeljes shuma rritet nga _____ në _____ lekë.

Çdo shkelje sipas paragrafit të parë të këtij neni, e kryer nga individë që janë ortakë ose aksionerë të personit juridik, kanë funksione drejtuese të personit juridik ose nga ortakë të vetëm të një shoqërie tregtare, dënohet me gjobë nga _____ në _____ lekë, dhe në rast përsëritje të shkeljes nga _____ në _____ lekë.

Sanksionet administrative të vendosura nga Bordi sipas këtij neni si dhe njoftimi për vendimin e marrë, nënshkruhen nga Kryetari i Bordit. Ankimimi në rrugë gjyqësore nuk e pengon ekzekutimin e vendimit të Bordit. Zyrat e Tatim-Taksave emërohen agjentë të Autoritetit dhe veprojnë në çdo rast për ekzekutimin e sanksioneve të vendosura nga Bordi e që nuk janë ekzekutuar vullnetarisht nga subjektet e mbikqyrura.

KREU XII

KOMPETENCA E AUTORITETIT PER ZBATIMIN

E MASAVE ADMINISTRATIVE

Neni 32

Përdorimi i masave administrative

Bordi me qëllim parandalimin apo ndërprerjen e shkeljeve të ligjit, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, parandalimin apo ndërprerjen e pasojave të rënda të shkeljeve të ligjit dhe në rastet e pengesave për ushtrimin e veprimtarisë mbikqyrëse të Autoritetit, mund të nxjerrë urdhëra për subjektet e mbikqyrur. Urdhërat duhet të trajtojnë mënyrën që duhet ndjekur nga subjektet e mbikqyrur për të korrigjuar situatën apo për të parandaluar dëmin. Urdhërat përmbajnë afatet për kryerjen e ndryshimeve apo korrigjimin e veprimeve.

Autoriteti mund të informojë publikun lidhur me masat e marra në zbatim të paragrafit të parë të këtij neni.

KREU XIII

DISPOZITA KALIMTARE

Neni 33

Përfundimi dhe transferimi i Kompetencave

Në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, përfundojnë kompetencat vendimmarrëse të:

1. Komisionit të Letrave me Vlerë të krijuar në mbështetje të ligjit nr. 8080 date 1.3.1996 « Për Letrat me Vlerë », i ndryshuar;
2. Autoritetit Mbikqyrës të Sigurimeve të krijuar në mbështetje të Ligjit nr. 9268 « Për Organizimin dhe Funkcionimin e Autoritetit Mbikqyrës të Sigurimeve », i ndryshuar.
3. Inspektoriatit të mbikqyrjes së instituteve të pensioneve të krijuar në mbështetje të Ligjit nr. 7943, date 1.6.1995 « Për Pensionet Suplementare dhe Institutet Private të Pensioneve », i ndryshuar.

Liçensat dhe vendimet e tjera individuale administrative lëshuar nga autoritet e përmendura në paragrafin e parë të këtij ligji, mbeten në fuqi.

Mjetet, burimet e të ardhurave, arkivat, detyrimet dhe kompetencat e tjera të Komisionit të Letrave me Vlerë, Autoritetit Mbikqyrës të Sigurimeve dhe Inspektoriatit të mbikqyrjes së instituteve të pensioneve përfshihen në asetet, arkivat, detyrimet dhe kompetencat e Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare. Ky proces mbyllet në momentin e shkrirjes së administratës së Komisionit të Letrave me Vlerë, Autoritetit Mbikqyrës të Sigurimeve dhe Inspektoriatit të mbikqyrjes së instituteve të pensioneve.

Neni 34

Emërimi i anëtarëve të parë të Bordit

Brenda 15 ditëve nga miratimi i këtij Ligji, institucionet paraqesin në Kuvend propozimet për anëtarët e Bordit.

Brenda 1 muaji nga marrja e propozimeve, Kuvendi emëron anëtarët e Bordit, ndërsa efektet e emërimit të tyre fillojnë nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Emërimi për herë të parë i anëtarëve të Bordit, bëhet sipas afateve të mëposhtme :

1. kryetari – 6 vjet
2. Njëri prej Nënkyetarëve – 5 vjet dhe tjetri – 4 vjet sipas përcaktimit të bërë në vendimin e emërimit;
3. anëtarët e tjerë përkatësisht; i pari – 4vjet; i dyti – 5 vjet, dhe dy të tjerët – 3 vjet, sipas përcaktimit të bërë në vendimin për emërimin e tyre.

Kryetari i Bordit thërret mbledhjen e parë të Bordit brenda 7 ditëve nga hyrja në fuqi e ligjit.

Neni 35

Mbarimi i funksioneve dhe shkrirja e administratave

të Komisionit të Letrave me Vlerë, Autoritetit Mbikqyrës të Sigurimeve

dhe Inspektoriatit të Instituteve Private të Pensioneve.

Me hyrjen në fuqi të këtij Ligji pushojnë së vepruari organet vendimmarrëse të Komisionit të Letrave me Vlerë, Autoritetit Mbikqyrës të Sigurimeve si dhe Inspektoriatit të Instituteve Private të Pensioneve. Me hyrjen në fuqi të këtij Ligji përfundon mandati i Anëtarëve të zgjedhur, ose emëruar në organet vendimmarrëse të këtyre institucioneve.

Brenda 3 (tre) muajve nga miratimi këtij ligji, shkrihen administratat e Komisionit të Letrave me Vlerë, Autoritetit Mbikqyrës të Sigurimeve si dhe Inspektoriatit të Instituteve Private të Pensioneve. Gjatë kësaj periudhe, Kryetari, sipas procedurave të miratuara nga Bordi, fillon rekrutimin e nëpunësve dhe punonjësve të tjerë të Autoritetit, duke trajtuar me përparësi të punësuarit në këto institucione. Gjatë kësaj periudhe personat që në këto administrata ushtrojnë funksione Ekzekutive, nuk kanë asnjë kompetencë vendimmarrëse. Ata janë përgjegjës për dorëzimin tek Kryetari i Autoritetit, të mjeteve, burimeve të të ardhurave, arkivave dhe, detyrimeve të tjera të përmendura në paragrafin e fundit të nenit 33 të këtij Ligji.

Të punësuarit në administratat e Komisionit të Letrave me Vlerë, Autoritetit Mbikqyrës të Sigurimeve si dhe Inspektoriatit të Instituteve Private të Pensioneve, të cilët nuk rekrutohen nga Autoriteti, përfitojnë të drejtat e parashikuar nga ligji « Për Statusin e Nëpunësit Civil ».

Neni 36

Caktimi i pagave, shpërblimeve dhe strukturës

për vitin e parë financiar

Për vitin e parë të aktivitetit, struktura e Autoritetit, paga e Kryetarit, paga e Nënkyetarit si dhe shpërblimi i Anëtarëve të tjerë të Bordit, bëhet nga Kuvendi me propozim të Këshillit të Ministrave, në momentin e miratimit të këtij ligji.

Neni 37

Buxheti i Autoritetit

për vitin e parë financiar

Buxheti i Autoritetit për vitin 2006 pëpilohe mbështetur në buxhetin e Komisionit të letrave me Vlerë, Autoritetit të Mbikqyrjes së Sigurimeve, dhe Inspektoriatit të instituteve private të pensioneve.

Ministri i Financave ngarkohet të bëjë ndryshimet në lidhje me përgatitjen e buxhetit të Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare për vitin 2006.

Brenda një muaji nga miratimi i këtij ligji, Këshilli i Ministrave paraqet për miratim në Kuvend, projekt-buxhetin e Autoritetit.

KREU XIV

DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 38

Terminologjia

Në këtë ligj termat kanë të njëjtin kuptim si në ligjet që rregullojnë secilin prej tregjeve financiare jo-bankare, që janë objekt i mbikqyrjes nga Autoriteti.

Në këtë ligj, termi « tituj », ka të njëjtin kuptim me termin « letra me vlerë ».

Neni 39

Hartimi i rregulloreve të Autoritetit

Bordi brenda dy muajsh nga data e fillimit të punës harton dhe miraton rregullat për strukturën dhe organizimin e punës së tij.

Bordi brenda 6 muajsh nga data e fillimit të punës, harton dhe miraton rregullat e tjera të lidhura me drejtimin e përditshëm të institucionit.

Neni 40

Shfuqizime

Ligji nr. 9268 date 29.07.2004 « Per organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikqyres te Sigurimeve », shfuqizohet.

Aktet nënligjore të dala në zbatim të ligjit nr. 8080 datë 1.3.1996 « Për Letrat me Vlerë », i ndryshuar, Ligjit nr. 9267 datë 29.07.2004 « Për Veprimtarinë e Sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime », i ndryshuar, si dhe Ligjit nr. 7943, datë 1.6.1995 « Për Pensionet Suplementare dhe Institutet Private të Pensioneve », i ndryshuar, të miratuara nga Këshilli i Ministrave e që bien në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohen.

Aktet nënligjore të miratuara nga autoritetet e rregulluara nga ligjet e përmendura në paragrafin e mësipërm, shfuqizohen.

Neni 41

Ndryshimet në Ligjin nr. 8080 datë 1.03.1996

« Për Letrat me Vlerë »

Neni 1 i Ligjit nr. 8080 datë 1.03.1996 « Për Letrat me Vlerë », shfuqizohet.

Në nenin 2 të Ligjit nr. 8080 datë 1.03.1996 « Për Letrat me Vlerë » dhe kudo ku është përdorur më pas fjala « Komision » zëvendësohet me « Autoriteti Mbikqyrës ».

Kreu II i Ligjit nr. 8080 datë 1.03.1996 « Për Letrat me Vlerë », shfuqizohet.

Kreu X i ligjit nr. 8080 datë 1.03.1996 « Për Letrat me Vlerë », Shfuqizohet.

Pikat 2, 3 dhe 4 te nenit 64 te Ligjit nr. 8080 datë 1.03.1996 « Për Letrat me Vlerë », shfuqizohen.

Neni 65 i Ligjit nr. 8080 datë 1.03.1996 « Për Letrat me Vlerë » shfuqizohet.

Neni 67 i Ligjit nr. 8080 datë 1.03.1996 « Për Letrat me Vlerë », shfuqizohet.

Neni 42

Ndryshimet në Ligjin nr. 7943, datë 1.6.1995 « Për Pensionet Suplementare dhe Institutet Private të Pensioneve »

Pikat 4 dhe 5 të nenit 1 të Ligjit nr. 7943, datë 1.6.1995 « Për Pensionet Suplementare dhe Institutet Private të Pensioneve » shfuqizohen.

Në pikën 10 të nenit 1 të Ligjit nr. 7943, datë 1.6.1995 « Për Pensionet Suplementare dhe Institutet Private të Pensioneve » dhe kudo ku është përdorur më pas, termi « depozitëmarrës » zëvendësohet me « depozitar ».

Në nenin 19 të Ligjit nr. 7943, datë 1.6.1995 « Për Pensionet Suplementare dhe Institutet Private të Pensioneve », fjala « inspektorët » zëvendësohet me « Nëpunësi i caktuar nga Zëvendëskryetari i Autoritetit Mbikyrës, Drejtues i Departamentit të instituteve private të pensioneve ».

Në Ligjin nr. 7943, datë 1.6.1995 « Për Pensionet Suplementare dhe Institutet Private të Pensioneve », kudo ku është përdorur fjala « leje », zëvendësohet me fjalën « liçensë ».

Në Ligjin nr. 7943, datë 1.6.1995 « Për Pensionet Suplementare dhe Institutet Private të Pensioneve », kudo ku është përdorur shprehja « institut privat i pensioneve », zëvendësohet me shprehjen « Autorite Mbikqyrës ».

Kreu XI, i Ligjit nr. 7943, datë 1.6.1995 « Për Pensionet Suplementare dhe Institutet Private të Pensioneve », shfuqizohet.

Neni 43

Sistemimi me zyra i Autoritetit

Këshilli i Ministrave, brenda 1 muaji nga miratimi i ligjit përcakton ambjentet e përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë së Autoritetit.

Neni 44

Hyrja në Fuqi

Ky ligj hyn në fuqi brenda 45 ditëve pas miratimit në Kuvend.

Prill 2006